



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"

VENDIM

Nr. 12 Data 03.10.2017

Për miratimin në parim të segmenteve lumore që kërkojnë rehabilitim në Basenin Ujor Vjosë

Në bazë të ligjit **Nr.111/2012 datë 15.11.2012** "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", përkatësisht, Seksioni 3, **Klasifikimi i ujërave**, Neni 25, **Objektivat mjedisorë**, "Objektivat mjedisorë për trupat me ujëra sipërfaqësore, nëntokësore, si dhe për zonat e mbrojtura vendosen me qëllim parandalimin e dëmtimit të trupave ujorë, si dhe mbrojtjen, shtimin dhe rehabilitimin e të gjithë trupave ujorë, si sipërfaqësorë dhe nëntokësorë", KREU X, EFEKTET E DËMSHME TË UJIT, Neni 68, **Përmbytjet**, "Organet e menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore, në bashkëpunim me strukturat dhe organet e qeverisjes vendore, janë përgjegjëse për parandalimin, përballimin dhe për rehabilitimin e gjendjes së shkaktuar", Neni 64, **Mbrojtja e brigjeve** "Mbrojtja e brigjeve është detyrë publike, që realizohet me anë të ndërtimeve, rindërtimeve dhe mirëmbajtjes së pritave, veprave veshëse dhe veprave e masave të tjera teknike, ku përfshihen edhe ato biologjike", Neni 65 **Mbrojtja e përkohshme**, "Personat fizikë a juridikë, vendas dhe të huaj, pas marrjes së miratimit nga organet e administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore, mund të kryejnë veprimtari mbrojtëse të përkohshme në raste emergjence".

Vendimit **Nr.5 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor", Vendimit **Nr.6 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjensisë së Basenit Ujor";

VENDOSI

Miratimin në parim të segmenteve lumore që kërkojnë rehabilitim në Basenin Ujor Vjosë me kushtet e mëposhtme :

Segmentet të cilat kërkojnë rehabilitim në shtratin e lumit Vjosë janë:

- **Lumi i Vjosës**
- Segmenti në fshatin Mifol, Ura e Lopës, segmentet në të dyja krahët.
- Segmenti i lumit në fshatin Kashisht (majtas dhe djathtas)
- Segmenti i fshatit Varibop
- Segmenti i fushës së Hambarit

- Segmenti nga fusha e Beshishtit deri tek kanali Vjosë-Levan-Fier
- Segmenti ku përfshihen fshatrat **Rromës**, Mollaj, Pocem
- Segmenti ku bashkohet Vjosa me Drinos

- **Lumi i Shushicës**
- Segmenti Bishti i malit-Armen-Picar
- Segmenti në pjesën e poshtme dhe të sipërme të urës së Drashovicës.

- **Lumi i Kalasës**
- Segmenti në rrjedhën e poshtme të lumit të kalasës për në detin Jon.

- **Lumi Pavllo**

- **Lumi i Dukatit**

Të merret si referencë raporti i përgatitur i ndërtuar mbi bazën e vrojtimeve direkte në terren dhe studimeve të detajuara për rehabilitimin e lumenjve të kryera në vitet 2005-2006 nga një grup i integruar ndërinstitucional, si edhe raporti " **MONITORIMI I DINAMIKES SE SHTRATIT NE LUMENJTE E SHQIPERISE NE PJESEN E MESME DHE TE POSHTME TE RRJEDHES DHE PROPOZIMI I MASAVE PER STABILIZIMIN E GJENDJES**" i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar Shkurt 2017.

- Të merren masa nga institucionet përkatëse në nivel qendror dhe vendor për projektet e rehabilitimit pjesor të lumenjve sipas segmenteve të përcaktuara në raport të cilat kanë nevojë për financime nga burime të tjera përveç aplikantëve.
- Nga ana e Drejtorisë së Politikave të Burimeve Ujore në bashkëpunim me Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tokave dhe Ujit në vitin 2017 duhet të përgatitet kërkesa për fonde të destinuar për këtë qëllim.
- Të monitorohen nga institucionet e mbrojtjes së tokave zonat që janë nën kërcënimin e erozionit për shkak të rrjedhës ujore të pasistemuar në lumenj dhe në përrenj.
- Shfrytëzimi pa kriter i lumenjve ka sjellë prishjen e regjimit të tyre dhe rritjen e shkallës së erozionit duke dëmtuar vepra të ndryshme hidroteknike, rrugë, banesa dhe biznese, etj.
- Ka depozitime të vazhdueshme të mbeturinave lumore në shtretërit e lumenjve që ka sjellë përkeqësimin e mëtejshëm të situatës. Të merren masa për krijimin e fondeve të veçanta nga MBZHR për pastrimin e mbeturinave lumore nga institucionet qendrore dhe vendore.
- Një sërë veprash të rëndësishme hidroteknike si argjinatura, prita etj. janë dëmtuar në një shkallë të madhe deri jashtë funksionit. Nga ana institucioneve përgjegjëse të ndërtimit të tyre të vlerësohet shkalla e dëmtimit të tyre.

- Të kryhen kontrole të rrepta për ruajtjen e shtretërve të lumenjve dhe monitorimin e zbatimit të lejeve në vazhdim.
- Të ndërpritet hedhjeve të mbeturinave urbane dhe pastrimin e tyre që janë hedhur.
- Mbjellje të pemëve në tarracat e lumenjve. Të merren masa për krijimin e fondeve të veçanta për mbjelljen e pemëve nga institucionet qendrore dhe vendore.
- Të ndërpritet shfrytëzimi i inerteve në shtretërit e të gjithë lumenjve
- Të merren masa për krijimin e fondeve të veçanta për pastrimin e rërës në pjesën e poshtme të të gjithë lumenjve kryesore.
- Të shfrytëzohen inertet malore për qëllime ndërtimi.
- Të vazhdojë procesi i largimit të impianteve të prodhimit të inerteve nga tarracat lumore.
- Të merren masa për krijimin e fondeve të veçanta për ndërtimin e pritave malore për grumbullimin e inerteve dhe shfrytëzimin e tyre.
- Për ndërhyrje në shtretërit e lumenjve për rehabilitimin e tyre është e nevojshme paraqitja e aplikimeve dhe projekteve teknike të plota dhe të detajuara nga ekspertet e fushës.
- Ideja për marrjen e inerteve nga shtretërit e lumenjve me qëllim rehabilitimin e tyre ose mbrojtjen nga erozioni, në çdo rast të kërkohet një studim paraprak dhe një projekt zbatimi
- Rehabilitimi i shtretërve të lumenjve dhe mbrojtjet gjatësore dhe tërthore të brigjeve janë probleme inxhinierike komplekse dhe mjaft të ndërlikuara dhe nuk mund të zgjidhen nga grupet që bëjnë një inspektim vizual të gjendjes në vend. Nevojiten projekte teknike të detajuara nga institucionet përgjegjëse.
- Të merren masa nga institucionet përgjegjëse për kryerjen e studimeve, hartime projektesh në fazë projekt-ide dhe projekte zbatimi nga specialist të fushës, për mbrojtjen e brigjeve, rehabilitimin e shtretërve dhe të grykëderdhjeve të lumenjve vetëm në funksion të rehabilitimit të lumenjve.
- Të përcaktohet nga Agjensia e Basenit Ujor Vjosë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tokave dhe Ujit si edhe me Drejtorinë e Politikave të Burimeve Ujore prioritet e rehabilitimeve.
- Të merren masa nga Drejtoria e Politikave të Burimeve Ujore si edhe STKKU, për plotësimin më dokumentet e nevojshme si edhe tarifave administrative që duhet tju kërkohen subjekteve të interesuara për rehabilitimin e lumenjve. Të përcaktohen referencat ligjore dhe dokumentacionet që duhen kërkuar për rehabilitim.
- Agjensia e Basenit Ujor Vjosë të mos pranojë asnjë dosje deri në momentin që nuk do të ketë formular aplikimi për rehabilitim.

Ngarkohet ABU për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËS I A.B.U. "VJOSË"

Ilir PROFKA



KRYETAR I K.B.U "VJOSË"

Etjona HOXHA

